




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



J@B NET
Fitnete MUJAJ
Drejtoreshë
Jabllanicë e Vogël
Pejë



VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2020/2 IPKO (Palë Ankuese) kundër J@B NET
("Palë Përgjegjëse")**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 31 dhjetor 2019, ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Pala Ankuese ndaj Palës Përgjegjëse. Pala Ankuese pretendon se Pala Përgjegjëse është duke ritransmetuar ndeshje të Premier Ligës Angleze përmes kanalit Super Sport Kosova 2 pa të drejta të ritransmetimit, ndeshje për të cilat Pala Ankuese posedon të drejtat ekskluzive të transmetimit për territorin e Republikës së Kosovës.
3. KPM, nëpërmes një shkrese me datën 6 janar 2020, e ka njoftuar Palën Përgjegjëse, për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe e ka kërkuar që ta errësojë kanalën gjatë transmetimit të këtyre ndeshjeve, duke vepruar kështu në pajtueshmëri me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM 2016/01.
4. KPM me datën 16 janar 2020, ka pranuar përgjigje nga ana e Palës Përgjegjëse, ku i mohojnë pretendimet e Palës Ankuese, duke cekur se nuk është duke transmetuar ndeshjet e Premier Ligës Angleze.
5. KPM, për të verifikuar pretendimet e Palës Ankuese, me datën 18 janar 2020, ka dalë në terren dhe ka vizituar selinë e Palës Përgjegjëse në kohën e transmetimit të ngjarjeve sportive të Premier Ligës Angleze, respektivisht në kohën kur po transmetohej ngjarja sportive e futbollit ndërmjet Ëatford-Tottenham, duke filluar nga ora 13:30.

6. Monitorimi në selinë e Palës Përgjegjëse e cila gjindet në fshatin Jabllanicë e Vogël, nuk ka qenë e mundur të bëhet nga zyrtarët e Zyrës Ekzekutive të KPM-së pasi që një gjë e tillë nuk është mundësuar nga personat përgjegjës të Palës Përgjegjëse.
7. Në këto rrethana, zyrtarët e Zyrës Ekzekutive të KPM-së janë detyruar të kërkojnë alternativë dhe të monitorojmë te klientët e operatorit, në fshatin fqinjë Radac. Gjatë monitorimit te klienti kemi gjetur se Pala Përgjegjëse ishte duke e transmetuar ngjarjen sportive futbollit ndërmjet Watford-Tottenham, duke filluar nga ora 13:30 që ishte edhe fokusi i këtij monitorimi.
8. KPM bazuar në raportin e monitorimit të datës 20 janar 2020, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, duke transmetuar pa marrëveshje ndeshjet futbollistike të Premier Ligës Angleze, ndeshje për të cilat Pala Ankuese posedon të drejtat ekskluzive të transmetimit për territorin e Republikës së Kosovës.
9. KPM bazuar në raportin e monitorimit të datës 20 janar 2020, gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka pasur në dispozicion as kanalën informues, që bazuar në nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, është obligim që çdo operator ta ketë në listën e kanaleve, kanalën informues që përdoret për komunikim me përdoruesit dhe informim të tyre.
10. KPM bazuar në raportin e monitorimit të datës 20 janar 2020, ka gjetur se Pala Përgjegjëse e ka pamundësuar për zyrtarët e Zyrës Ekzekutive të KPM-së, që të realizojnë monitorimin në selinë e tij, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 19, paragrafi 2, të Rregullores KPM 2016/01, pasi që Zyra Ekzekutive e KPM-së ka të drejtë të monitorojë në çdo kohë çfarëdo pjese të sistemit të rrjetit të shpërndarjes të të licencuarit.

Analiza Ligjore

11. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse, është gjetur në shkelje të nenit 4, paragrafi 1, nenit 12 paragrafi 2, si dhe nenit 19, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.”

12. KPM, bazuar në raportin e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, duke transmetuar pa marrëveshje ndeshjet futbollistike të Premier Ligës Angleze, ndeshje për të cilat të drejtën ekskluzive për territorin e Republikës së Kosovës e posedon Pala Ankuese.

Neni 12, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari duhet të krijojë një “kanal informues” i cili, duhet të përdoret vetëm për komunikim me përdoruesit dhe informim të tyre”.

13. KPM, gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka pasur në dispozicion as kanal informues, që bazuar në nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, është obligim që duhet çdo operator ta ketë në listën e kanaleve, kanal informues që përdoret për komunikim me përdoruesit dhe informim të tyre.

Neni 19, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“KPM-ja ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë çfarëdo pjesë të sistemit të rrjetit të shpërndarjes të të licencuarit, të inspektojë dokumentet dhe shënimet që ndërlidhen me licencën e KPM-së, të monitorojë numrin, kualitetin dhe përmbajtjen e të gjitha shërbimeve programore të ofruara nga të licencuarit”.

14. KPM, bazuar në raportin e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse e ka pamundësuar për zyrtarët e Zyrës Ekzekutive të KPM-së, që të realizojnë monitorimin në selinë e tij, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 19, paragrafi 2, të Rregullores KPM 2016/01, pasi që KPM ka të drejtë të monitorojë në çdo kohë çfarëdo pjese të sistemit të rrjetit të shpërndarjes të të licencuarit.
15. Komisioni i KPM-së konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të marr hapat e nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1, nenin 12, paragrafi 2, si dhe nenin 19, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.

Vendimi

16. Urdhërohet Pala Përgjegjëse që të ndërpresë menjëherë ritransmetimin e ndeshjeve futbolistike të Premier Ligës Angleze dhe çdo përmbajtje tjetër programore për të cilat nuk posedon marrëveshje për të drejtën e transmetimit, në mënyrë që të veprojë në pajtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
17. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumë prej 2,000 (dymijë) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, nenit 12 paragrafi 2, si dhe nenit 19, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.
18. Nëse Pala Përgjegjëse, edhe pas pranimit të këtij Vendimi nuk e ndërpret ritransmetimin e ndeshjeve futbolistike të Premier Ligës Angleze ose ndonjë përmbajtje tjetër programore për të cilat nuk posedon marrëveshje për të drejtën e transmetimit, Komisioni i KPM-së do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë


19. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim

dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

20. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Ekzekutimi i Vendimit

21. Ankesa e parashtruar kundër këtij vendimi nuk e pengon ekzekutimin e tij dhe se ky vendim bëhet i plotfuqishëm në momentin e pranimit nga Pala Përgjegjëse, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 2, pika 2 të Ligjit të KPM-së.


Muja FERATI
Kryetar



02.03.2020
Datë